



Gjiri i Lalezit, Durres
Shqiperi
Komplekset Turistike "Lura 1,2, 3"

Njoftim

Te nderuar banore,

Urojme qe ky njoftim t'ju gjeje mire.

Ne mbeshtetje te veprimtarise se kompanise OnService per vitin 2021 dhe ne kuader te permiresimit te sherbimit te ofruar nga ne dhe cilesise se bashkejeteses se banoreve te Lura 1,2 dhe 3 kerkojme tju njoftojme mbi masat qe do ndermerren nga ne.

Kryesite e banoreve per secilin kompleks jane njoftuar paraprakisht mbi keto masa si dhe mbi kostot vjetore qe kompania ka per ofrimin e sherbimit.

Hyrje-daljet

1. Hyrja dhe dalja ne komplekse do vazhdoje te behet vetem permes trareve ekzistues por nga ky vit nepermjet **kartave te rezidentit** te cilat do te perfitohen me shlyerjen e tarifes vjetore. Cdo rezident do te kete nje karte te perfshire ne tarife ndersa kartat ekstra mund te merren kundrejt nje pagese ne kosto te kartes.
2. Te gjithe punonjesit privat qe operojne ne kompleks duhet te pajisen me karta rezidenti ne rast se duan te aksesojne me mjete ne kompleks.
3. Vizitoret ne komplekse do ndalohen te futen pa nje njoftim paraprak ose pa nje verifikim me banorin qe e pret prandaj kerkohet nga banoret kontakti telefonik.

Tarifat 2021

1. Tarifa vjetore per rezidentet e komplekseve nga ky vit do te ndryshoje ne baze te llojit te njesise se banimit.
2. Per banoret qe jetojne ne njesi banimi apartament, pra pa siperfaqe oborri private, tarifa do te jete **240 euro ne vit**. Per banoret te cilet jetojne ne njesi banimi vile individuale apo te perbashket dhe qe kane siperfaqe oborri private, tarifa vjetore do te jete **360 euro ne vit**. Ne tarife perfshihet edhe karta e rezidentit.
3. Tarifa vjetore mund te paguhet Cash ne zyren e OnService ne Lura 1 ose permes bankes ne llogarite e OnService.
4. Tarifa vjetore paguhet e plote ose sipas nje plani te darkodesuar.

Sherbimet e perfshira.

Ashtu si ne vitin 2020 sherbimet e OnService do perfshijne:

1. Pastrimin e komplekseve nga mbetjet organike ne ambjentet e perbashketa
2. Mbledhjen e mbeturinave familjare nga kontenieret e mbeturinave ne brendesi te komplekseve
3. Rregullimin, sistemin e reres si dhe pastrimin e saj ne menyre periodike
4. Mirembajtjen e ndricimit dhe te gjelberimit ne ambjentet e perbashketa
5. Mbikqyrjen e hyrje-daljeve ne komplekse dhe patrullimin ne brendesi te tyre nga punonjesit tone te sigurise.
6. Sistemimin e ambjenteve te perbashketa te amortizuara si dhe njoftimin e autoriteteve shtetere per nderhyrje ne pergjegjesi te tyre.

Plazhi

1. OnService do vijojte edhe kete vit te operoje me zona publike, private dhe ekskluzive.
2. Zonat ekskluzive per banoret e kompleksve do hartohen ne nje takim me kryesite e banoreve ne menyre qe te jene te sistemuara edhe per cadrat private gje e cila ndihmon pastrimin periodik te reres.
3. Edhe kete vit do te kete set cadre me shezllone me abonim vjetor per banoret.

Investime

Ne tabelen e paraqitur kryesise se banoreve mbi shpenzimet e kompanise OnService parashikohet edhe nje fond minimal rezerve per rregullime estetike dhe siperfaqesore ne komplekse. Ne momentin kur problemi eshte serioz dhe kerkon nderhyrje tersore atehere do kerkohet nga kryesia mbledhja e nje fondi specifik ne baze te nje preventivi per zgjidhjen e problemit.

Duke falenderuar nje pjese te mire te banoreve qe vitin e kaluar kane qene korrekt me pagesat dhe duke shpresuar qe te gjitha te shlyejne detyrimin e tyre kete vit, shlyerja e te cilit pasqyrohet direkt ne punen tone, OnService ju uron nje vit te mbare.

Faleminderit,

OnService shpk

web: www.onservice.al

email: info@onservice.al

Cel: +355 69 575 6615